



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI - CORRUPTION AGENCY



KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dop. DPK
Nr. Prot. 03-03/1759/18
Nr.faq 03
Data 21-06-2018
Nr. pages
PRISHTINE

DATE/A:	21.06.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-1614/18
PËR/ZA/TO:	z. Abaz FONIQI Menaxher i zyrës së Prokurimit Komuna e Klinës
CC:	z. Zenun Elezaj Kryetar i Komunës së Klinës
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin me titull: “Renovimi i objektit të komunës” Lot 1: “Renovimi i kulmit; Lot 2: “Dyshemeja, suvatimi dhe fasada”; Lot 3: “Hidroizolimi dhe Drenazhimi” me nr. të prokurimit 634/18/4227/521, nr. të brendshëm 634/18/027/521.

I nderuar z. Foniqi,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2017, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores nr.01/2014 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: **“Renovimi i objektit të komunës” Lot 1: “Renovimi i kulmit; Lot 2: “Dyshemeja, suvatimi dhe fasada”; Lot 3: “Hidroizolimi dhe Drenazhimi”** me nr. të prokurimit 634/18/4227/521, nr. të brendshëm 634/18/027/521, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull: **“Renovimi i**

objektit të komunës” Lot 1: “Renovimi i kulmit; Lot 2: “Dyshemeja, suvatimi dhe fasada”; Lot 3: “Hidroizolimi dhe Drenazhimi” me nr. të prokurimit 634/18/4227/521, nr. të brendshëm 634/18/027/521, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Arsyëtimi

Agjencia kundër Korrupsionit, me datë 20 qershor 2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: AKK-03-03-1614/18, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Renovimi i objektit të komunës” Lot 1: “Renovimi i kulmit; Lot 2: “Dyshemeja, suvatimi dhe fasada”; Lot 3: “Hidroizolimi dhe Drenazhimi”** me nr. të prokurimit 634/18/4227/521, nr. të brendshëm 634/18/027/521, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Klinës.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma **E-Prokurimi**, ka analizuar njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe pjesën e specifikimeve teknike, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë të hapur, kontratë publike, llojit punë, me vlerë të mesme të parashikuar 60.000.00€. Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ka vërejtur se autoriteti kontraktues si kriter për dhënie të kontratës ka caktuar kriterin Tenderi ekonomikisht më i favorshëm, ndërsa si nën kritere i ka caktuar: 1. Çmimi të cilit i ka caktuar koeficientin prej 0.50%, nën kriteri 2. Garancionet pas shitjes koeficientin prej 0.30%, dhe nën kriterin 3. Afati i Implementimit me koeficient 0.20%.

Agjencia kundër Korrupsionit, konsideron se autoriteti kontraktues me rastin e caktimit të nën kriterit për dhënie të kontratës nën kriterin nr. 3. *“Afati i Implementimit me koeficient 0,20%”*, nuk ka respektuar Legjislacionin në fuqi të Prokurimit Publik, për faktin se në nenin 28 paragrafi 3 Rregullat dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimi Publik, specifikohen qartë cilat kritere mund të caktohet te kriteri i dhënies Tenderi ekonomikisht ma i favorshëm. Agjencia, konsideron se autoriteti kontraktues mund të caktoj afatin kohor e implementimit ashtu siç parashihet ne Kushtet e veçanta të kontratës konkretisht ne nenin 12.1, ku thuhet: *Kontraktuesi duhet të dorëzoj për aprovim programin e punës brenda 8 ditëve nga data e nënshkrimit te kontratës.*

Agjenci kundër Korrupsionit, rekomandon autoriteti kontraktues që në rast se specifikon në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit kriterin për dhënie të kontratës tenderin ekonomikisht më te favorshëm, duhet të këtë kujdes që të caktoj nën kritere të qarta, precize dhe të cilat janë kritere të matshme dhe që janë relevante me lëndën e kontratës, e që në rastin konkret nën kriteri nr. 2 Garancioni pas shitjes, është nën kriter i cili më tepër kërkohet të aktivite e prokurimit të cilat kanë të bëjnë me furnizime.

Agjenci kundër Korrupsion, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 27, nenin 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 28 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkeljet e tilla nuk duhet lejuar ne aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsion rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar te gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se për këto të gjetura do të njoftohet edhe KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !